



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA E TIRANËS

QENDRA EKONOMIKE E ZHVILLIMIT DHE EDUKIMIT TË FËMIJËVE

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____, ____, 2018

Formular i njoftimit të fituesit

Data 21/05/2018

Për: Operatorin Ekonomik **“InfoSoft Office”** Sh.p.k.

Adresa : Kodër Kashar, Autostrada Tirane - Durres Km 8, Kashar, Tiranë.

Procedura e prokurimit: **Kërkesë për propozim.**

Numri i Referencës për Procedurën: **Blerje mjete didaktike dhe kancelarike ne funksion te projektit "Bejme detyrat e shtepise" dhe mjete kancelarike per nevojat e QEZHEF: REF-42437-01-26-2018.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Objekti “Blerje mjete didaktike dhe kancelarike ne funksion te projektit "Bejme detyrat e shtepise " dhe mjete kancelarike per nevojat e QEZHEF” me fond limit 2 004 271 (dy milion e katër mijë e dyqind e shtatëdhjetë e një) lekë pa T.V.SH. Fondi i mësipërm nuk i përfshin të gjitha detyrimet fiskale si dhe T.V.SH-në.

Publikime të mëparshme: **Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 5, Datë 05 Shkurt 2018**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X, oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Shoqëria **“ADASTRA”** Sh.p.k

L41826018M

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera e ofertës ekonomike të paraqitur është 1 494 000 lekë pa T.V.SH.

2. Shoqëria **“InfoSoft Office”** Sh.p.k

InfoSoft Office

J62426002Q

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera e ofertës ekonomike të paraqitur është 1 573 730.95 lekë pa T.V.SH.

___ Adresa: Rruga “Barrikadave”, Kodi Postar 1001, tel.: +355 42222991, web: femijetetiranes.al, email: femijet@tirana.al ___

3. Shoqëria “PAERA” Sh.p.k

PAERA

L31505034R

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Nuk ka paraqitur ofertë.

4. Shoqëria “Pc Store” Sh.p.k

Pc Store

L01606034A

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera e ofertës ekonomike të paraqitur është 1 982 350 lekë pa T.V.SH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1) “ADASTRA” Sh.p.k

1.1 Kriteret e përgjithshme, pika 1.d, operatori ekonomik nuk rezulton të ketë likuiduar të gjitha detyrimet tatimore sipas legjislacionit në fuqi. Nga verifikimi në sistemin e-albania rezulton të ketë detyrime të papaguara për “Tatim mbi vlerën e shtuar”

1.2 Kriteret e veçanta, pika 2.3.3, operatori ekonomik nuk ka paraqitur katalogun shoqërues për magnetofon, qëndër zëri sipas kërkesave në DST.

1.3 Kriteret e veçanta, pika 2.3.4 operatori ekonomik nuk ka paraqitur mostrat e kërkuara ditën e hapjes së ofertave.

Oferta ekonomike: 1 494 000 lekë pa T.V.SH.

2) “InfoSoft Office ” Sh.p.k

2.1 Kriteret e përgjithshme, pika 1.d, operatori ekonomik nuk rezulton të ketë likuiduar të gjitha detyrimet tatimore sipas legjislacionit në fuqi. Nga verifikimi në sistemin e-albania rezulton të ketë detyrime të papaguara për “Tatimi mbi fitimin”.

Oferta ekonomike: 1 573 730.95 lekë pa T.V.SH.

3) “PAERA” Sh.p.k

3.1 Operatori ekonomik ka paraqitur vetëm dokumentin që vërteton përmbushjen e kriterit të veçantë pika 2.3.2, çertifikatë ISO 9001: 2015 ose ekuivalente.

Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

4) “PS STORE” shpk

4.1 Kriteret e vecanta të kualifikimit, pika 2.3.4, operatori ekonomik nuk përmbush kriteret sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga Ak për mostrat:

4.1.1 Artikulli “Postera për ciklin e ulët”

OE ka paraqitur vetëm një fletë kartoni.

Kjo mostër nuk plotëson specikimet teknike të kërkuara.

4.1.2 Artikulli: “Komplet shkronjash”

Në specifikimet teknike kërkohet “Komplet shkronjash druri”

OE ka paraqitur një komplet shumë të vogël shkronjash dhe numrash plastike.

Kjo mostër nuk plotëson specikimet teknike të kërkuara.

4.1.3 Artikulli: “Ngjitës shirit nga të dyja anët”

Në specifikimet teknike kërkohet “Biadeziv me gjerësi 3cm”

OE ka paraqitur një ngjitës biadeziv me gjerësi 5 mm.

Kjo mostër nuk plotëson specikimet teknike të kërkuara.

4.1.4 Artikulli: “Pjata plastike”

Në specifikimet teknike kërkohet pako me 50 copë pjata.

OE ka paraqitur si mostër, pako me 20 copë pjata.

Kjo mostër nuk plotëson specikimet teknike të kërkuara.

4.1.5 Artikulli: “Telajo”

Në specifikimet teknike është kërkuar me përmasat 50 cmx50cm, druri 20x30mm

OE ka paraqitur një mostër me përmasat 18x24 cm.

Kjo mostër nuk plotëson specikimet teknike të kërkuara.

4.1.6 Artikulli: Letër Adezive

Në specifikimet teknike është kërkuar: Letër Adezive, Formati A4 (Pako 100 fije)

OE ka paraqitur “Letra me ngjyra”

Kjo mostër nuk plotëson specikimet teknike të kërkuara.

4.1.7 Artikulli: Rrathë gjimnastikorë

Në Specifikimet teknike është kërkuar “Rrathë gjimnastikor me diametër 80 cm”

OE ka paraqitur një “Rrathë të modifikuar”

Kjo mostër nuk plotëson specikimet teknike të kërkuara.

4.1.8 Artikulli: “Magnetofon”

Në specifikimet teknike është kërkuar: “Impiant Hi-Fi , fuqia dalese 3 Wat, përmasat 252x232x124mm”

OE ka paraqitur si mostër “Një box që punon vetëm me Wi-Fi”

Kjo mostër nuk plotëson specikimet teknike të kërkuara.

4.1.9 Artikulli: Qendër zëri”

Në specifikimet teknike kërkohet: “Sistem audio. 1 Box te amplifikuar 300 Wat. 1 mixer 2-3 kanale, 1 mikrofon me kabell, 1 stativ mikrofon”.

OE ka paraqitur:

Sistem Audio të markës JBL, profesional harman.

Fuqia 160 Wat.

Mixer me 6 kanale

Mikrofon

Stativ mikrofon.

Fuqia e impiantit mostër është me e vogël se ajo e kërkuar.

Kjo mostër nuk plotëson specikimet teknike të kërkuara.

4.1.10 Artikulli “Harta e Shqipërisë”

Në specifikimet teknike është kërkuara me përmasat 2mx70cm

OE ka paraqitur një mostër me përmasat 100cmx70cm

Kjo mostër nuk plotëson specifikimet teknike të kërkuara.

4.1.11 Artikulli: ‘Dosje me llastik’

Në specifikimet teknike është kërkuar “Dosje me llastik me trashësi 3cm”

OE ka paraqitur dosje me llastik me trashësi 2 cm.

Kjo mostër nuk plotëson specifikimet teknike të kërkuara.

4.1.12 Artikulli: “Dosje me lidhëse”

OE nuk ka paraqitur mostër.

4.1.13 Artikulli: “Dosje me mekanizëm”

Në specifikimet teknike kërkohet “Dosje me mekanizëm me kuti 8 cm”

OE ka paraqitur “Dosje me mekanizëm pa kuti”

Kjo mostër nuk plotëson specifikimet teknike të kërkuara.

4.1.14 Artikulli: “Blok Fletë-Hyrje”

Në specifikimet teknike kërkohet “Vetëkopjuese 3 kopje”

OE ka paraqitur bllok Fletë-Hyrje Vetëkopjuese 2 kopje

Kjo mostër nuk plotëson specifikimet teknike të kërkuara.

4.1.15 Artikulli: “Blok Fletë-Dalje”

Në specifikimet teknike kërkohet “Vetëkopjuese 3 kopje”

OE ka paraqitur bllok Fletë-Dalje Vetëkopjuese 2 kopje

Kjo mostër nuk plotëson specifikimet teknike të kërkuara.

4.1.16 Artikulli: “Makinë llogaritëse”

Në specifikimet teknike kërkohet Makinë llogaritëse 16 dig.

OE ka paraqitur si mostër Makinë llogaritëse 12 dig.

Kjo mostër nuk plotëson specifikimet teknike të kërkuara.

4.1.17 Artikulli: “Boje per Printer/ skaner/ fotokopje Xerox Copier Workcenter 5021”

Në specifikimet teknike për tonarat, kërkohet që ato të jenë të mbyllur në qeska hermetike.

Boja “Toneri” i paraqitur nuk është i mbyllur në qeska hermetikisht.

Kjo mostër nuk plotëson specifikimet teknike të kërkuara.

4.1.18 Artikulli: “Boje per printer HP LazerJet P1005”

Mostra e paraqitur nuk përputhet me specifikimet e kërkuara.

PN (Part Number) i mostrës së paraqitur nuk përputhet me atë të kërkuar.

Kjo bojë nuk i përshtatet printerit HP LazerJet P1005.

Kjo mostër nuk plotëson specifikimet teknike të kërkuara.

Oferta ekonomike: 1 982 350 lekë pa T.V.SH.

Përsa mësipër njoftimi i klasifikimit u publikua në datë 26.02.2018.

Në vijim më datë 02.03.2018 në Autoritetin Kontraktor u paraqit ankesa e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” mbi klasifikimin. Më pas operatori ka paraqitur ankesë në KPP dhe më datë 09.05.2018 pranë AK, u depozitua Vendimi Nr. 289 datë 08.05.2018 i KPP, për kualifikimin e operatorit ekonomik “InfoSoft Office”, konkretisht vendimi i KPP ka disponuar:

“ 1. Të pranojë ankesën e Operatorit ankimues “Infosoft Office” Sh.p.k, për Procedurën e

prokurimit “Kërkesë për propozim” me objekt “Blerje mjete didaktike dhe kancelarike në funksion të projektit *Bejme detyrat e shtepise "dhe mjete kancelarike per nevojat e QEZHEF"*”.

2. *Autoriteti Kontraktor të anullojë vendimin e KVO-së lidhur me skualifikimin e Operatorit Ekonomik “InfoSoft Office” Sh.p.k, duke e kualifikuar atë”.*

Më datë 10.05.2018 Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në zbatim të Vendimit të KPP, Nr. 289 datë 08.05.2018, ka bërë në sistem kualifikimin e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” sh.p.k.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik: “InfoSoft Office” sh.p.k, me adresë kryesore: Kodër Kashar, Autostrada Tirane - Durres Km 8, Kashar, Tiranë, se oferta e paraqitur, prej 1 573 730,95 (një milion e pesëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e tridhjetë presje nëntëdhjetë e pesë) lekë pa T.V.SH dhe 1 888 477,14 (një milion tetëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë presje katërmëdhjetë) lekë me T.V.SH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të depozitoni pranë **Autoritetit Kontraktor, Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve**, me adresë Rr. “Barrikadave”, Çerdhja Nr. 1, Tiranë, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar), siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 10.05.2018.

Titullari i Autoritetit Kontraktor

Zhaneta BEQIRI